



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 2311 Prot.
11

Tiranë, më 06 . 11 . 2025

VENDIM

Nr. 300, datë 1.10.2025

**“PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL
PËR PROKURORIN SHQIPONJA MILLA”**

Mbështetur në nenin 149/a, pika 1, germa “a”, të Kushtetutës, në nenin 95, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 159, 161, 164, pika 8, 184, germa “dh”, 189, pika 1, germa “a”, 190 të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, në Vendimin nr. 95, datë 09.05.2022, “Për miratimin e Rregullores “Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve”, e ndryshuar, e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe pasi u njoh me projektraportin e përgatitur nga Relatori, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit të vlerësimit etik dhe profesional të prokurorit Shqiponja Milla, për periudhën 01.01.2017 – 31.12.2019, duke e vlerësuar si më poshtë:
 - a. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm” – 100 (njëqind) pikë;
 - b. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm” – 96 (nëntëdhjetë e gjashtë) pikë;
 - c. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – Shkëlqyeshëm – 100 (njëqind) pikë;
 - d. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm” – 95 (nëntëdhjetë e pesë) pikë.
 - Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm” – 391 (treqind e nëntëdhjetë e një) pikë.
2. Raporti i vlerësimit sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar, vetëm për shkelje të rënda procedurale.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë në përputhje me nenin 95, pika 9, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar.

U shpall në Tiranë, sot më 1.10.2025.



KRYETAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Moisi Duda

ANËTAR
Erind Merkuri

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Vatë Staka

ANËTAR
Erion Fejzulla

ZV/KRYETAR
Erind Gërmenji

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Olger Eminaj